



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 97/1 Prot.

Tiranë, më 13.02.2015

VENDIM

Nr. 17, datë 13/02/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr.97 Prot., datë 26.01.2015, ndaj autoritetit publik/Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni” sipas së cilës pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, Z. \_\_\_\_\_ në datë 12.01.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/ Universitetit “Ismail Qemali”, kërkesën për informacion, bashkëlidhur të cilës gjendet dokumenti “dëftesë për pranimin e objekteve postare” datë 12.01.2015. Nëpërmjet saj, kërkuesi ka kërkuar ti vihen në dispozicion kopje të dokumenteve zyrtare, konkretisht:

1. Listë prezenca në punë e pedagoges \_\_\_\_\_, për vitet 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014;
2. Listë pagesa e pedagoges \_\_\_\_\_ për vitet 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014;
3. Listë prezenca në punë e \_\_\_\_\_ për vitet 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014;
4. Listë pagesa e \_\_\_\_\_ për vitet 2011-2012, 2012-2013, 2013-2014;
5. Të ardhurat mujore dhe vjetore të \_\_\_\_\_ që nga viti 2010 deri në vitin 2014.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur ankesës rezulton se kërkesa është trajtuar brenda afatit ligjor, konform nenit 15/1 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” nga autoriteti publik/Universiteti “Ismail Qemali”. Në përgjigjen e dhënë Universiteti ka argumentuar se informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale në referim të përcaktimeve të nenit 3/1 të të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Pas shqyrtimit të legjislacionit rezulton se informacioni/dokumentacioni i kërkuar nuk i përket kategorisë së informacionit që bëhet publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Rezulton se, dokumentacioni i kërkuar i përket periudhave të gjata kohore dhe në përmbajtje të tij gjendet të dhëna personale. Në përputhje me

ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të dhënat personale mbahen për aq kohë sa përfundon qëllimi për të cilin ato janë mbledhur. Në përfundim të përmbushjes së qëllimit nga kontrolluesi/Universiteti, të dhënat personale duhet të shkatërrohen apo të kodohen nëse autoriteti publik vlerëson mbajtjen e tyre për të tjera qëllime të argumentuara duke bërë me dije edhe subjektin e të dhënave personale. Gjithashtu, për çdo të dhënë sensitive të evidentuar në dokumentacionin e kërkuar, siç mund të jetë identifikimi i raporteve mjekësore, autoriteti publik detyrohet të kryejë përpunimin e tyre vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave personale apo për përmbushjen e një detyrimi ligjor të autoritetit publik/Universitetit. Sa i përket kërkesës për pajisje me dokumentacionin që i përket “të ardhurave mujore të ” çmohet se informacioni i kërkuar duhet të krijohet dhe si i tillë ai nuk i nënshtrohet zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtëne informimit”. Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa është e pabazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës së , nr.97 Prot., datë 26.01.2015, ndaj autoritetit publik/Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 13.02.2015.

